



# Vizionimi i Çarshisë




# së Madhe në Gjakovë

**EC**  
MA NDRYSHË



Dhjetor, 2023



## “VIZIONIMI I ÇARSHISË SË MADHE NË GJAKOVË”

Autore: Arta Januzi Gana, Flaka Xërxa Beqiri


Aida Aliu, Erza Gjoshi, Fatgzona Jakupi

Botues: **EC Ma Ndryshe**

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &  
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7  
www.ecmandryshe.org  
info@ecmandryshe.org  
029 222 771 & 038 224967

Ky raport vizionimi është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Zbatimi i programeve të strategjisë të EC” i përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



## Përmbajtja

Hyrje.....	5
1.0 Gjendja ekzistuese e Çarshisë së Madhe në Gjakovë .....	8
1.1 Historiku zhvillimor dhe rëndësia .....	8
1.2 Trajtimi hulumtues dhe zhvillimor.....	14
1.3. Dispozita ligjore.....	19
1.4. Gjendja aktuale fizike .....	20
1.5. Rastet studimore të marra në shqyrtim .....	36
2.0 Punëtorja e vizionimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë .....	40
2.1 Qëllimi i punëtorisë dhe objektivat.....	40
2.2 Mjetet dhe metodologjia e punës.....	43
2.3 Rezultatet e dalura nga punëtoritë sipas mjeteve të punës .....	47
3.0 Vizionimi i Çarshisë së Madhe në Gjakovë.....	61
3.1 Koncepti i vizionimit .....	61
3.2 Definimi i pesë shtyllave programore .....	65
3.3 Propozimi i ndërhyrjeve konceptuale në strukturën ekzistuese .....	71
Rekomandime për hapa të më tutjeshëm zhvillimor të Çarshisë së Madhe në Gjakovë .....	95
Bibliografia.....	97

## Hyrje

Bërthamat historikë të qyteteve tona ishin dhe mbeten treguesit më të qartë të nivelit tonë të civilizimit si shoqëri, duke reflektuar mbi vlerat sociale, kulturore, ekonomike dhe politike të vendit tonë. Mbi të gjitha, zhvillimet e trasuara ndër shekuj në këto struktura fillestare urbane, reflektojnë tipare të identitetit tonë urban e shoqëror. Si e tillë mund pakrahasueshmerisht të konsiderohet Çarshia e Madhe e Gjakovës, e cila përveç se e cilësuar si çarshia më e madhe në Evropën Juglindore, përbën njëherit edhe çarshinë më të vjetër në Kosovë.

Çarshia e Madhe e Gjakovës është një tërësi e rëndësishme urbane që bartë vlera të trashëgimisë kulturore në nivel shtetëror. Me karakteristikat e saj arkitekturore dhe organizimin specifik urban, kjo tërësi formon një ansambël monumental karakteristik dhe me interes për tu studiuar, vlerësuar, mbrojtur dhe

promovuar. Bazuar në vlerat që bartë, Çarshia e Madhe e Gjakovës është e listuar në listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (06.10.2023 – 06.10.2024), me numër unik 334 në databazë, e kategorizuar si tërësi e mbrojtur urbanistike, në nënkategorinë: fushat e konservimit arkitektonik.

Në zhvillimin e saj historik, përveç rolit primar të cilin kishte, atë të zhvillimit të ekonomisë vendore dhe ndër rajonale, Çarshia e Madhe e Gjakovës luajti rol kyç në zhvillimin social, kulturor dhe politik të qytetit të Gjakovës dhe komplet rajonit.

Pozita e saj e favorshme gjeografike në njërin anë, dhe niveli zhvillimor në anën tjetër, e penalizuan në raport të rreziqeve që iu kanosën gjatë luftërave. Rrjedhimisht Çarshia e Madhe ishte cak i shkatërrimeve që në periudhën e luftërave ballkanike, e për të vazhduar me luftën e fundit (1999) kur strukturat e saj përjetuan dëmtime rrënjësore.

Megjithëse e rindërtuar (2000 - 2002), Çarshia e Madhe e Gjakovës në dy dekadat e fundit humbi vëmendjen publike që kishte sa i përket nivelit zhvillimor në rangun ekonomik, kulturor e social. Mospërkujdesja institucionale, rënja e ekonomisë në nivel të zhvillimit komunal, dhe mungesa e aktivitetit të orientuar kulturor e social, ndikuan në përkeqësimin e gjendjes së përgjithshme fizike të tërësisë urbane të Çarshisë së Madhe.

Së fundmi, përpjekjet e ndryshme për intervenime me qëllim të përmirësimit të strukturës së saj fizike dhe adaptimin e saj për nevojat e përdorimit të sotëm u përballën me kritika publike dhe mëdyshje nga ana e komunitetit dhe profesionistëve. Reagimi publik ndaj ndërhyrjeve të fundit në Çarshinë e Madhe (2012) që kishte për fokus trajtimin e trasesë së rrugës qendrore, solli edhe protesta.

Sot, Çarshia e Madhe lë shumë për të dëshiruar sa i përket gjendjes së saj fizike

dhe nivelit të shfrytëzueshmërisë e funksionalitetit. Punime të intervenimeve të filluara dhe të pa përfunduara, llojllojshmëri e materializimit të trasesë rrugore, lokale të mbyllura, zeje të shuara, mungesë e ndriqimit publik etj., janë disa nga problemet lehtësisht të identifikuara përgjatë një ecjeje. Shtuar këtu edhe pakënaqësinë dhe zhgënjimin e shprehur në baza ditore të qytetarëve dhe pronarëve të bizneseve, Çarshia e Madhe transmeton nevojën imediate për intervenime në regjenerimin urban të saj.

Ky raport vizionimi vie si iniciativë e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, respektivisht Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Gjakovë, në bashkëpunim me OJQ EC Ma Ndryshe, dhe me kontribut të Komunës së Gjakovës, për të bërë vizionimin e Çarshisë së Madhe të Gjakovës, bazuar në metodologjinë e planifikimit me pjesëmarrje.



## 1.0 Gjendja ekzistuese e Çarshisë së Madhe në Gjakovë

### 1.1 Historiku zhvillimor dhe rëndësia

Fillet e sotme të Gjakovës, qytet perëndimor i Kosovës i njohur me emrin burimor Jakova, llogaritet të kenë nisur si vendbanim i veçantë në tokën e dikurshme të banuesit Jak Vula, prej të cilit edhe rrodhi emri Jakovë (Jak -oval - fusha e Jakës). Sipas gojëdhënave, në tokën e tij të falur, zunë fill strukturat e para të ndërtuara të Gjakovës së sotme, ndër të cilat padyshim Xhamia e Hadumit (1594/1595).

Sipas të dhënave të dokumentuara të Sanxhakut të Shkodrës, Gjakova në vitin

1582 ishte fshat dhe zonë e zhvillimit tregtar. Tradita e shkëmbimit të mallrave datonte edhe më heret, që në vitin 1485.

Qyteti ekzistues i Gjakovës konsiderohet të jetë themeluar gjatë periudhës së pushtimit otoman, përkatësisht në fund të shekullit të XVI-të, kur edhe mori epitelin e një qyteti të vogël. Në këtë periudhë, Hadum Sylejman Efendia, i njohur si Hadum Aga, Hadumit.

hamami, mejtepi, biblioteka etj., sot njihet jo vetëm si struktura më e vjetër ndërtimore e qytetit të Gjakovës, por poashtu edhe si pikënisje e zhvillimit të mëtutjeshëm të tërësisë urbane të Çarshisë së Madhe.

Funksionimi i Gjakovës si zonë e shkëmbimit tregtar dhe zhvillimit të tregtisë në përgjithësi vazhdoj edhe gjatë sundimit të Perandorisë Osmane. Ansambli i Xhamisë së Hadumit dhe objekteve përcjellëse, bashkarisht me dyqanet e para të ndërtuara përreth në të cilat operonin zejtarët e parë, mund të konsiderohet se përbëjnë bërthamën e sotme të Çarshisë së Madhe dhe të vetë qytetit të Gjakovës. Sot literatura e njeh Çarshinë e Madhe të Gjakovës si çarshinë më të madhe në



Fig. 1 Xhamia e Hadumit e ndërtuar nga Hadum Sylejman Efendia (1594/1595)



Evropën Juglindore, dhe njëherit si çarshinë më të vjetër në Kosovë.

Zhvillimet ekonomike që ndodhën në të, i dhanë epitetin edhe qytetit të Gjakovës qytet i tregtisë dhe mallrave. Tregtia dhe shkembimi i mallrave që zunë vend në këtë tërësi urbane i shërbyen jo vetëm fshatrave përreth, por poashtu zhvilluan një ekonomi të ndërsjelltë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë [CHWB Kosova, 2015].

Çarshia e Madhe e Gjakovës numëronte mbi 500 struktura ndërtimore, në kuadër të së cilave lindën dhe u zhvilluan shumë zeje, duke përfshirë këtu terzitë, kujunxhitë, furragjitë, kundraxhitë, kallajxhitë, kutixhitë, jorganxhitë dhe shumë zeje të tjera.

Në Çarshinë e Madhe spikatej ndarja e prodhimtarisë së zejeve sipas principit të

zonimit të aktiviteteve. Kështu në pjesën lindore të çarshisë ishin të pozicionuar përpunuesit e mëndafshit, të veshjeve dhe të kopsave, ndërsa në anën jugore vepronin orëpunuesit dhe argjendarët. Në pjesën jugore të kompleksit, në te dy anët e dyqaneve gjindeshin zejet si: jogranxhinjtë, gezofxhinjtë, briskpunuesit, armëpunuesit, qilimtarët dhe bakërpunuesit. Karakteristikë e çarshisë ishte "Rruga e Kutixhinjëve" në të cilën ishin të pozicionuar të gjithë zdruckhtarët [Kryeziu, A., 2014].

Mekanizmi i prodhimit dhe shërbimeve që u zhvillua në tërësinë urbane të Çarshisë së Madhe, bëri që Gjakova deri në vitet e 70-ta të kishte lidhje të fuqishme tregtare me Shqipërinë, respektivisht me Shkodrën.

Fig. 2. Fotografi të vjetra të Çarshisë së Madhe në Gjakovë



Për Çarshinë e Madhe shkroi edhe udhëtari turk Evlia Çelebiu, i cili vizitoi Gjakovën në vitin 1662. Çelebiu ndër të tjera dokumentoi edhe numrin e madh të zejeve që po zhvilloheshin në atë periudhë në çarshi: "Gjakova ka dy mijë shtëpi të zbukuruara të vendosura në një fushë të gjerë. Ka dy xhami të bukura, një banjë të bukur publike (hamam) që kënaq zemrën tënde dhe rreth treqind dyqane me një mijë lloje të zanateve".

Prodhimtaria aktive e çarshisë shërbente jo vetëm për nevojat e komunitetit të rajonit të Gjakovës, por ishte dukshëm e zhvilluar edhe në nivel eksporti, duke përfshirë këtu punimet e metalit, të lëkurës, tekstilit, qilimave, enëve, leshit etj. Më vonë, ndikimi i

esnafëve nuk konsistonte vetëm në zhvillimin e ekonomisë, por gjithashtu edhe në ngritjen e nivelit të zhvillimit shoqëror dhe politik të qytetit të Gjakovës.

**Ilustrimi në vijim: Çarshija e Madhe e Gjakovës ndër vite; zhvillimi i saj historik, turistik e zejtar.**

Fig.3 Fotografia të vjetra të Çarshisë së Madhe në Gjakovë



Çarshia e ka humbur rolin e saj si qendër ekonomike pas luftës së dytë botërore, me hapjen e fabrikave dhe zhvendosjen e aktiviteteve ekonomike të qytetit në bregun e majtë të lumit Krena.

## 1940

Çarshia deri në vitet e 70-ta të shekullit XIX kishte një lidhje të fuqishme tregtare me Shkodrën, që mundësoi eksportimin e prodhimeve në vendet e largëta dhe furnizimin me mallëra luksozë dhe artikuj kolonialë (Shkodër-Kosovë-Nish- Sofje-Konstantinopojë).



## 1940

Çarshia e madhe e Gjakovës njihej si qendër e zejeve ku zhvilloheshin gati të gjitha llojet e zejeve të lidhura me një sistem zingjiror të prodhimit dhe tregtisë (përpunimi i metaleve, lëkurës, tekstilit, drurit, etj) dhe shërbimeve.



Zhvillimi i hovshëm ekonomik e industrial është ndërprerë dhunshëm me shkatërrimin e Çarshisë më 1912 gjatë periudhës së luftërave Ballkanike.

## 1957

## QENDËR E ZEJEVE 1936

Rënia e vazhdueshme e zejtarisë është shënuar kur ka filluar importimi i prodhimeve industriale, në periudhën mes dy luftërave, si pasojë e konkurrencës së prodhimeve të importuara industriale.

Fluksi zhvillimor i çarshisë pësoj rënje me zhvillimin e industrializmit dhe pakësimin e nevojës për prodhimet artizanale. Venitje e aktiviteti zhvillimor u shënuan në periudhën e pas luftës së dytë botërore, kur zhvillimi ekonomik i Gjakovës u koncentrua në hapjen e fabrikave dhe promovimin e zhvillimit industrial. Goditjet e fundit Çarshia e Madhe e Gjakovës i pësoj në periudhën e pas luftës së fundit në Kosovë (1999), kur megjithë investimeve për rekonstruimin e saj, u bë shumë pak në drejtim të promovimit të bizneseve dhe aplikimit të lehtësirave për operimin e tyre, duke lënë në këtë mënyrë dyqanet dhe rrugët e çarshisë të mbyllura. Megjithatë, sot Çarshia e Madhe e Gjakovës përbën një tërësi urbanistike të një rëndësie të veçantë, qoftë në aspektin e kualitetit vizuel/vëllimor, poashtu edhe për nga rëndësia e saj e transmetuar ndër shekuj në cilësinë e kompleksit kulturor, historik, turistik, tregtar dhe zejtar.

**Ilustrimi në vijim: Pasivizimi i Çarshisë së Madhe në Gjakovë.**

**FUNKSIONET PRIMARE NË ÇARSHI :**

- |   |              |   |              |
|---|--------------|---|--------------|
| 1 | Rrobaqepës   | 4 | Argjendar    |
| 2 | Këpucëtar    | 5 | Jorganxhinjë |
| 3 | Teneqepunues | 6 | Sahatçi      |



Rrobaqepës



Teneqepunues




Funksione të përziera

**FUNKSIONET AKTUALE NË ÇARSHI NGA GJITHSEJ 525 LOKALE :**

**146**

Të Mbyllura



**34**

Kafiteri



**15**

Tekstil



**241**

Të tjera



Kafiteri



Tekstil



Të tjera

## 1.2 Trajtimi hulmtues dhe zhvillimor


Çarshia e Madhe e Gjakovës vazhdimisht i është ekspozuar kërkesës për regjenerim dhe adaptim progresiv ndaj nevojave të kohës, duke patur për qëllim primar ruajtjen e karakterit të saj fillestar ballkanik-oriental.

### Studimi i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe të Gjakovës 1979-1982

Në rradhën e aktiviteteve më të rëndësishme për trajtimin hulmtues dhe zhvillimor të saj mund të konsiderohet

nisma e Fakultetit të Arkitekturës në Sarajevë, me anagazhimin e studentëve kosovarë në këtë fakultet (1979), për revitalizimin e Çarshisë së Madhe gjatë së cilës u bë evidentimi dhe valorizimi i gjendjes ekzistuese të çarshisë si dhe përcaktimi i parimeve të përgjithshme për revitalizimin e saj. "Studimi i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë" në vitin 1979 u pasua me me vendimin për planin e rregullimit të "Çarshisë së Madhe" të vitit 1982 [EC Ma Ndryshe, 2015].

Fig. 4. Fragmente nga projekti "Studimi i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë"



Sipas një rezymeje të dhënë nga njëri ndër autorët e projektit të "Studimit i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe të Gjakovës", Kurtoviq, publikuar në revistën "Antikitetet e Kosovës" (1987), kjo nismë dha rezultate në krijimin e një pasqyre të përgjithshme mbi nevojën për revitalizimin e çarshisë, ruajtjen e vlerave kulturore-historike dhe estetike të këtij ansambli monumental, dhënjen e propozimeve për aktivizimin e zejeve të dikurshme dhe tregtisë, dhënjen e propozimeve për zhvillimin e turizmit përmes afirmimit të punimeve tradicionale të artizanatit dhe punëdoreve etj. Projekti poashtu parashihte përcaktimin e zhvillimit kronologjik të tipologjisë së mikroelementeve të çarshisë si dhe përcaktimin tipologjik të objekteve sipas strukturës ndërtimore dhe materialeve të aplikuara.

Propozimet e dalura nga ky projekt trajtonin: komunikacionin, hapësirat mikrorurbane, rregullimin e hortikulturës dhe elementeve të dekorit urban, ndriqimin publik, vendosjen e reklamave, shkallën e lejuashme të intervenimeve arkitektonike në objekte etj. Projekti poashtu propozonte nevojën e përtëritjes së zejeve të vjetra të çarshisë, mënjanimin e veprimtarive që nuk janë në harmoni me strukturën e saj themelore si dhe mënjanimin e qarkullimit të automjeteve (përveç atyre për furnizim) dhe lirimin e hapësirave të çarshisë vetëm e vetëm për nevoja të këmbësorëve. Ky projekt i cili ngërthente në vete edhe fazën e studimit të fizibilitetit të inicuar në vitet e '70ta përbën njërin nga iniciativat më serioze drejt revitalizimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë [Kurtiq, 1987].

### **Projekti për restaurimin e Çarshisë së Madhe të Gjakovës 2000 - 2002**

Pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë (1999) u inicua projekti për restaurimin e Çarshisë së Madhe të Gjakovës me qëllim të rindërtimit të strukturave që kishin pësuar djegie dhe poashtu atyre të cilat ishin tashmë të dëmtuara skajshmërisht nga këto zhvillime. Kjo iniciativë, për shkak të emergjencës së reagimit, kishte pak kohë në dispozicion për përpunimin e mirëfilltë të projektit restaurues, dhe po i njëjti ishte më shumë i bazuar në të dhanat e "Studimi e Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe të Gjakovës". Investimet e bëra në çarshi në këtë periudhë varionin nga investimet e organizatave ndërkombëtare, e deri te investimet vetanake të pronarëve të lokaleve dhe pronave të cilat kishin pësuar djegie. [Kryeziu, A., 2014].



Fig.5. Fotografi të Çarshisë së Madhe në Gjakovë pas djegies



## **Ngjarjet e fundit interventuese në Çarshinë e Madhe të Gjakovës 2012 - 2022**

Situata e rënduar e Çarshisë së Madhe të Gjakovës si rezultat i mospërkujdesjes institucionale solli devastimin gradual të strukturave fizike të saj, dhe njëherit humbjen e potencialit zhvillimor, duke ndikuar në mbylljen e shumë bizneseve aktive dhe zejeve tradicionale, humbjen e aktivitetit dhe çarkullimit ditor në të dhe venitjen e gradualtë të rëndësisë kulturore, sociale, zhvillimore që kishte.

Si kundërpërgjigje ndaj kësaj situatë, digasterët komunalë të cilët udhëhiqeshin nga formacione politike në ndryshim të përhershëm (shkaktuar nga zgjedhjet e shpeshta lokale), ndërmorrën disa iniciativa për intervenime në Çarshinë e Madhe të Gjakovës, kryesisht të karakterist sanues. Kështu në vitin 2012 u ndërmor intervenimi në trasenë e rrugës qendrore të çarshisë, me ç'rast u bë zëvendësimi i shtresës burimore të saj, kallëdermit me materializim jo-burimor. Me shprehjen e indinjatës

publike nga ana e qytetarëve dhe pronarëve të bizneseve aktive në çarshi, punimet u kërkuan të ndalonin, përderisa kishte edhe organizim të protestive dhe nismave mbrojtëse të manifestuara në platformat sociale.

Nisma e fundit e ndërrmarë në drejtim të intervenimeve sanuese në kuadër të Çarshisë së Madhe në Gjakovë është projekti i iniciuar nga Drejtorja e Shërbimeve Publike nga Komuna e Gjakovës (2022), projekt i cili i është nënshtruar procedurave aprovuese dhe riveduese në kuadër të Komisionit Profesional të Insitutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. Projekti, sipas parimeve të paracaktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të duhej të kishte për bazë këto parime kryesore:

- Filozofia e konservimit do të duhet të bazohet në ruajtjen maksimale të materialit original dhe autentik, kthimin e gjendjes burimore në rastet që mbështeten në të dhëna faktike dhe

adaptimin e ndërtesave për nevoja të kohës

- Punët do të duhej të ekzekutoheshin me respekt ndaj metodave teknologjike dhe tradicionale duke iu përmbajtur autenticitetit material dhe shpirtëror
- Vendimet për ndryshim do të duhej të ishin të arsyeshme, transparente dhe konsistente
- Ruajtja e mëtutjeshme të bazohej në menaxhim dhe mirëmbajtje të rregullt.

Bazuar në dokumentin e MKRS-së të datës 19.05.2022, me Nr.Ref. 2105/2022, ndaj projektit të propozuar nga operatori ekonomik është paraqitur ankesë sa i përket materialit të propozuar për trasenë e rrugës qendrore të Çarshisë së Madhe, i cili nuk përkon me gjendjen burimore për nga specifikacioni, dimensionimi dhe dizajni.

### **Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë - 2015**

Në vitin 2015, CHwB Kosova në bashkëpunim me përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe lokale, përfaqësues të

komunitetit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë dhe të Grupit Këshillues të Komunitetit (të themeluar në kuadër të projektit), kanë hartuar dokumentin "Hapësira Historike Urbane - Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë". Ky dokument vë në pah deri në punën e Forumit Lokal për Trashëgiminë Kulturore të Gjakovës, të themeluar në kuadër të Programit të Planeve Lokale të Trashëgimisë Kulturore (2012-2015), në kuadër të së cilit, në rradhënë e projekteve të rëndësishme është paraparë projekti "Hartimi i Strategjisë për Rifunksionalizimin e Çarshisë së Madhe të Gjakovës (CHwB, 2015).

Dokumenti jep të dhëna mbi vizionin, parimet dhe synimet kryesore mbi Çarshinë e Madhe të Gjakovës, të propozuara nga grupi punues, të cilat parashohin: Krijimin e kornizës organizative (Synimi 1), Ruajtjen dhe shfrytëzimin e veçantisë së çarshisë (Synimi 2) dhe Zhvillimin e lëvizshmërisë, trafikut dhe ngritjen e kualitetit (Synimi 3).

### 1.3. Dispozita ligjore

Për vlerat e trashëgimisë kulturore që bartë, Çarshia e Madhe e Gjakovës është e listuar në listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (06.10.2023 – 06.10.2024), me numër unik 334 në databazë, e kategorizuar si tërësi e mbrojtur urbanistike, në nënkategorinë: fusha e konservimit arkitektonik.

Megjithë statusit nën mbrojtje që gëzon, Çarshia e Madhe e Gjakovës është shumë pak e trajtuar në dokumentet dhe dispozitat tjera ligjore që do të mund t'i ofronin hulumtuesve, profesionistëve dhe përfaqësuesve institucional të dhëna më të shumta rreth specifikave të saj. Ndër të tjera, kufiri i saj mbrojtës, bashkë me zonën rrethuese të nevojshme përreth (bufer zonën) ende nuk është i definuar [bazuar në takimin me përfaqësues të institucioneve dhe profesionistë në takimin e mbajtur në Gjakovë, me date 18 Nëntor, 2023]. Sipas dokumentit të fundit publik mbi Çarshinë e Madhe të Gjakovës, "Hapësira Historike

Urbane - Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë", kufiri i kësaj zone do të duhej të mirrte formë zyrtare me vendim të MKRS-së, pas analizave që do të realizoheshin gjatë hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm [CHwB, 2015].

Ky i fundit, deri në momentet e realizimit të këtij raporti mbetet i pa qasshëm dhe jo publik, edhe pse në draft dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Gjakovës, 2022-2030", "Plani Rregullues i Hollësishëm - Çarshia e Madhe Gjakovë" i hartuar për Zonën Historike të Çarshisë së Madhe të Gjakovës në vitin 2017, mbetet plani i vetëm legjitim në kuadër të të cilit janë paraparë të gjitha masat mbrojtëse të kësaj zone.

Përfundimisht, Çarshia e Madhe e Gjakovës mbetet pa kufij të definuar mbrojtës, dhe pa referencë të bazuar për masat mbrojtëse në kuadër të saj. Gjithashtu specifikat e saj si tërësi urbane që prezenton nuk janë të definuara në asnjërin nga dokumentet e planifikimit hapësinor të territorit të Gjakovës.

#### **1.4. Gjendja aktuale fizike**

Çarshia e Madhe e Gjakovës referuar historisë zhvillimore të saj si tërësi urb-arkitektonike, përbënë bërthamën e qytetit të Gjakovës. Ajo kufizohet me lumin Krena, përgjatë së cilit shtrihen disa ura kaluese të cilat e lidhin tërësinë urbane të Çarshisë së Madhe të Gjakovës me pjesën tjetër të qytetit të Gjakovës të zhvilluar në anën lindore të lumit.

Sipërfaqja e Çarshisë së Madhe të Gjakovës, bazuar në kufirin me të cilin përfaqësohet në dokumentet e fundit publike [CHWB, 2015], është gjithsejt 2,6 hektarë, duke e bërë atë njërin prej çarshive më të mëdha në rajon.

**Ilustrimi në vijim: Pozita e Çarshisë së Madhe të Gjakovës në kuadër të qytetit.**



PEJË

Jahoc

Qerim

PRISHTINË

QERIM

ZONA INDUSTRIALE

LUMI TRAKANIQ

LUMI KRENA

QENDRA E QYTETIT

KODRA E ÇABRATIT

ÇARSHIA E MADHE  
SIP. 2.6H

PRIZREN

SHQIPËRI

BLOKU I RI

BREKOC

QAFË PRUSH

LUMI ERENIKU

PARKU I SHKUGËZËS

ÇARSHIA E GJAKOVËS

0 100 200 300 400m

Bazuar në zhvillimin historik të Çarshisë së Madhe të Gjakovës, nga shpërndarja funksionale e ndërtesave në kuadër të bërthamës së saj kuptojmë se aksi veri-jugor i çarshisë stimuloj zhvillimin e dyqaneve në të cilat zhvilloheshin zejet e para dhe shkëmbimi i mallrave. Dyqanet me aktivitetin tradicional të zejeve ishin dhe vazhdojnë të jenë prezente edhe përreth kompleksit të Xhamisë së Hadumit, si dhe lokacionit të njohur si "Lama e Drithit". Në periferi të lokaleve afariste gjejmë prezencë të shtëpive individuale, të cilat shtrihen deri në kufijtë e skajshëm të çarshisë. Është evidente se ndërtesat e banimit dhe ndërtesat e destinimit shërbyes-afarist përbëjnë dy përmbajtjet më dominuese në kuadër të Çarshisë së Madhe të Gjakovës. Përpos tyre mund të evidentojmë një numër të konsiderueshëm të ndërtesave publike të cilat janë vendosur për të ushtruar veprimtarinë e tyre në ndërtesa të trashëgimisë kulturore në kuadër të çarshisë. Gjithashtu, në kuadër të ndërtesave aktuale mund të evidentojmë

ndërtesa arsimore, qendra kulturore, aktivitet hotelierik si dhe ndërtesa me destinim të përzier.


**Ilustrim në vijim: Përcaktimi funksional i ndërtesave në kuadër të Çarshisë së Madhe në Gjakovë.**




# HARTA E DESTINIMIT TË OBJEKTEVE DHE RRJETI RRUGOR

## LEGJENDA :

- NDËRTESAT PRIVATE TË BANIMIT
- NDËRTESAT PRIVATE TË BIZNESIT (DYQANE)
- NDËRTESAT PRIVATE TË BIZNESIT PAS VITIT 2005
- NDËRTESAT PUBLIKE
- RRJETI RRUGOR
- - - KUFIRI I ÇARSHISË
- LUMI KRENA



# ÇARSHIA E GJAKOVËS






# DESTINIMI I NDËRTESAVE PËRRETH PERIMETRIT RRUGOR

- LEGJENDA
- BANIM
  - KOMERCIALE
  - ADMINISTRATIVE
  - DESTINIM I PËRZIER
  - MONUMENTE
  - QENDRA KULTURORE
  - HOTELERIKE
  - NDËRTESA ARSIMORE
  - VEND ARKEOLOGJIK
  - RRUGËT
  - KUFIRI I ÇARSHISË
  - LUMI KRENA



# ÇARSHIA E GJAKOVËS





I gjithë kompleksi i Çarshisë së Madhe të Gjakovës paraqet një tërësi urb-arkitektonike me vlera të trashëgimisë kulturore, por edhe vlera të zhvillimit social, ekonomik e historik të vetë komunitetit jetues dhe veprues brenda kufijve të çarshisë. Gjithsesi, vlerat e përgjithshme të Çarshisë së Madhe të Gjakovës vetëm sa shtohen me përmbajtjet e shumta të monumenteve kulturore në kuadër të kufijve të saj, përkatësisht të një numri të madh të ndërtesave të trashëgimisë kulturore. Në këtë kontekst vlenë të përmenden: Kompleksi i Xhamisë së Hadumit, Kulla e Sahatit, Teqja e Sheh Eminit, Teqja e Bektashinjëve, Medreseja e Madhe, Xhamia e Kuqe, Shtëpia e Familjes Kryeziu, Kulla e Familjes Kryeziu, Kulla e Hysni Koshit, Shtëpia e Familjes Bakalli, Hani i Haraçisë dhe një numër i konsiderueshëm i ndërtesave të tjera të trashëgimisë kulturore.

**Ilustrimi në vijim: Ndërtesat e trashëgimisë kulturore në kuadër të Çarshisë së Madhe në Gjakovë.**



# HARTA E NDËRTESAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

- LEGJENDA
- RRUGËT
  - KUFIRI I ÇARSHISË
  - LUMI KRENA



**KULLA E ABDULLAH PASHË DRENIT**



**SHTËPIA E FAMILJES KRYEZIU**



**XHAMIA E KUQË**



**TEQJA E SHEH EMINIT**



**OBELISKU I PRIZRENIT**



**KULLA E HYSNI KOSHTI**



**SAHAT KULLA**



**TEQJA E MADHE**



**MEDRESJA E MADHE**



**XHAMIA E HADUMIT**



**SHTËPIA E FAMILJES GREZA**



**HANI I HARAÇISË**



**"TABHANE"**




**SHTËPIA E FAMILJES BAKALLI**



**TEQJA BEKTASHINJËVE**

# ÇARSHIA E GJAKOVËS



Megjithë vlerave të trashëgimisë kulturore, sociale, zhvillimore dhe të memorjes kolektive që kjo tërësi urb-arkitektonike bartë në vete, gjendja aktuale fizike e çarshisë dëshmon për probleme të mëdha. Vrojtimet në terren dëshmojnë se çarshia është duke u përballur me infrastrukturë të rënduar fizike, me dominim të gjendjes jo të mirë të materializimit rrugor, trajtimit të ujërave dhe ndriqimit publik. Më së shumti kualitetin fizik dhe vizuel të çarshisë e rëndon materializimi i ndryshëm rrugor, i cili derivon sidomos nga intervenimet e fundit të bëra në vitin 2012, kur është bërë largimi i kalldërmit dhe devastimi i gjendjes burimore të saj. Humbja e autenticitetit (në krahasueshmëri me imazhet e trashëguara në arkivat komunale nga gjendjet e hershme të çarshisë) vërehet edhe në trajtimin e strehëve të dyqaneve, llojit të zejeve të cilat sot ushtrohen në çarshi, si dhe mënyrës së trajtimit të finesave arkitektonike në objektet që shtrihen përgjatë çarshisë.

Probleme të tjera që transmetohen në gjendjen fizike aktuale janë: numri i lartë i bizneseve jo aktive, ndërtesa të braktisura, lëvizshmëri e rënduar e qytetarëve dhe turistëve si rezultat i prezencës së madhe të automjeve si dhe poashtu menaxhim dhe mirëmbajtje e dobët e çarshisë. Trajtimi i shtratit të lumit Krena përmes betonizimit të tepërt është poashtu njëra ndër problemikat më së shumti të vërejtshme në vrojtimin e përgjithshëm të çarshisë.

**Ilustrimet në vijim: Evidentimi i gjendjes fizike në kuadër të Çarshisë së Madhe në Gjakovë ; Listimi i problemeve dhe potencialeve në kuadër të Çarshisë së Madhe në Gjakovë.**



8

# EVIDENTIMI I PROBLEMEVE KYRESORE SIPAS GJENDJES FIZIKE

LEGJENDA  
 RRUGËT  
 KUFIRI I ÇARSHISË  
 LUMI KRENA

1



MATERIALIZIMI I RI  
JO-ADEKUAT

2



QASJA ME MAKINA  
NË AKSIN KYRESOR

3



BETONIZIMI I  
SHTRATIT TË LUMIT

4



NDËRTESA TË  
DËMTUARA

5



HUMBJA E AUTENTICITETIT  
NË DISA ZONA

6



PRANIA E SHATËRVANIT

7



MUNGESA E NJË STAFI  
MENAXHUES



MUNGESA E NDRIQIMIT  
NË TËRËSINË E ÇARSHISË



MUNGESA E  
AKTIVITETEVE



RRETHROTULLIMI SI  
PENGESE



GJENDJA E RËNDUAR E  
INFRASTRUKTURËS  
AKTUALE



NDËRTESA TË  
DJEGURA



BIZNESE JOAKTIVE



HAPËSIRA E NGUSHTË  
PËR MAKINA DHE  
MUNGESA E TROTUARIT

9

10

11

12

13

14












# ÇARSHIA E GJAKOVËS



# HARTA E TRASESË SË DYSHEMEVE

## LEGJENDA:

-  MBULESË E VJETËR ME KUBËZA NGA GURI
-  MBULESË ME BLOKA NGA GURI
-  MBULESË E RE ME BLOKA NGA GURI
-  MBULESË GURI ME RRASA
-  MBULESË E VJETËR ME GURËZA
-  MBULESË ME ASFALT
-  SHTEGU PËR KËMBËSOR ME BLOKA NGA GURI
-  KUFIRI I ÇARSHISË
-  LUMI KRENA



# ÇARSHIA E GJAKOVËS





1 DISHARMONIA **ARKITEKTURALE**  
2 MATERIALIZIMI I FASADAVE  
3 ZMBULESA E DYSHEMESË



2 3 MISHKRIMET NËPËR **ÇARSHI**  
4 LLOJET E KULMEVE

ÇARSHIA E  
GJAKOVËS



1 LLOJET E MBULESËS SË ÇATIVE

2 TABELA REKLAMUESE TË BIZNESEVE

3 VENDOSJA E KONDICIONERËVE NË FASADA BALLORE

4 KATET E PARA TË SHTUARA

ÇARSHIA E  
GJAKOVËS

1 MATERIALIZIMI I DYSHEMESË

2 FASADA E DËMTUAR

3 TIPOLOGJI E KONSTRUKSIONIT NGA DRURI

2

4 DËMTIMI I NDËRTESAVE NGA DJEGJA

5 DËMTIMET E DYSHEMESË URBANE

4

3

5




1 TIPOLOGJITË E HAPJEVE TË DYQANEVE

2 TIPOLOGJIA E STREHËVE TË DYQANEVE

3 TABELA REKLAMUESE TË BIZNESEVE

4 HEQJA E FONTANËS DHE RIKTHIMI I LOMËS SË DRITHIT



ÇARSHJA E  
GJAKOVËS


## INFRASTRUKTURA RRUGORE

Çasja e veturave  
Rrugë të dëmtuara



## HUMBJA E AUTENTICITETIT

Largimi i Kalldërmit



## TRAJTIMI I LUMIT

Ndotja  
Vizurat  
Gjelbërimi



## MUNGESA E AKTIVITETEVE

Frekuentimi më i madh i Çarshisë



## SHTEGU PËR KËMBËSORË

Vështirësi në çasje nga ana e këmbësorëve



## NDRIÇIMI

Sigurria dhe çasja në Çarshi



## MBYLLJA E NUMRIT TË MADH TË BIZNESEVE

Humbja e funksioneve primare




## MUNGESA E STAFIT MENAXHUES

Zhvillimi i Çarshisë



## OBJEKTE TË DËMTUARA

Ndikimi në sigurinë dhe pamjen estetike të Çarshisë



## RIKTHIMI NË NJË ZONË HISTORIKE DHE TURISTIKE

Frekuentimi më i madh i Çarshisë



## KRIJIMI I HAPËSIRAVE KULTURORE DHE REKREATIVE

Zhvillimi i Çarshisë si tërësi

Zhvillimi në aspektin kulturor



## INTEGRIMI I HAPËSIRAVE TË GJELBËRTA TE PJESA E LUMIT

Krijimi i gjallërisë dhe harmonisë urbane



## ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE TË NDRYSHME

Integrimi i Komunitetit



## ZHVILLIMI I TURIZMIT

Afërsia me lokacione të rëndësishme si Çabrati, Shkugzën etj.



## RIKTHIMI I FUNKSIONEVE BAZË

Ruajtja e Origjinalitetit



## SHFYTËZIMI I HAPËSIRAVE ME POTENCIAL ZHVILLIMI

Integrimi i programeve shtesë



## TRASHËGIMIA KULTURORE

Ndërtesa të vjetra rreth 400 vite



### **1.5. Rastet studimore të marra në shqyrtim**

Gjendja aktuale e Çarshisë së Madhe në Gjakovë, marrë për bazë problemet dhe potencialet që bartë, bën thirrje për një proces të regjenerimit urban, nga i cili do të mund të reflektohej mbi intervenime të nevojshme në strukturën fizike dhe përmbajtësore të saj.

Lidhur me këtë, gjatë këtij procesi vizionues, janë marrë në shqyrtim intervenimet e aplikuara në çarshitë simotra në rajon dhe më gjerë, për të reflektuar mbi rastet e suksesshme dhe ato lehtë të adaptueshme në rastin e Çarshisë së Madhe në Gjakovë.

Në rradhën e rasteve studimore të marra në shqyrtim, mund të bëjmë një klasifikim të tyre në dy tipologji të ndryshme, atë të çarshive tradicionale dhe mënyrës së adaptimit të tyre në nevojat e sotme, si dhe të çarshive (respektivisht tregjeve) me karakter më bashkëkohor.

Nga grupi i parë i çarshive të analizuara janë shqyrtuar modalitetet e regjenerimit të çarshive tradicionale, mënyra e promovimit të zejeve të vjetra, mënyra e ekspozimit të eksponateve për shitje dhe për tërheqje të vizitorëve, materializimi, mobiliari urban dhe elementet të tjera të kualitetit vizuel dhe arkitektonik. Ndërsa në grupin e dytë të çarshive të analizuara, është vënë në shqyrtim aspekti programativ që disa nga tregjet bashkëkohore publike sot kanë aplikuar në strukturat e tyre, me qëllim të tërheqjes sa më të madhe të vizitorëve.

**Ilustrimet në vijim: Rastet studimore të shqyrtuara në cilësinë e rasteve referencë.**



1757

## ÇARSHIA E GJIROKASTRËS

Qyteti i sotëm i Gjirokastrës përfshin Qytetin e Vjetër, me kalanë (bërthama e parë e vendbanimit) dhe lagjet e tipit osman, ndërtuar mbi kreshta, që vijjnë duke u larguar nga kalaja deri në tabanin e luginës, ku ndodhen ndërtimet bashkëkohore dhe kompleksi universitar. Lagjet tradicionale shtrihen në formë rrezeshe rreth kalasë me emrat: Çfakë, Dunavat, Manalat, Palorto, Varosh, Meçite, Hazmurrat, Pazari i Vjetër.



Punimi i qilimave

## ÇARSHIA E SHKUPIT

Është pazar i vendosur në Shkup, Maqedoninë e Veriut, në bregun lindor të lumit Vardar, që shtrihet nga Ura e Gurit deri në Bit-Pazar dhe nga Kalaja e Shkupit deri në lumin Serava. Çarshia e Vjetër bie kryesisht në kufijtë e Komunës së Çairit, por një pjesë e saj ndodhet në Komunën e Qendrës. Si një nga tregjet më të vjetra dhe më të mëdha në Ballkan, ai ka qenë qendra e Shkupit për tregti të paktën që nga shekulli i 12-të.

1489



1533

## ÇARSHIA E KRUJËS

Pazari i Krujës ndryshe i njohur edhe si Pazari i Derexhikut, shtrihet në të dy anët e rrugës së shtruar me kall-dërm që të çon drejt kalasë së Krujës. Nga vendasit njihet ndryshe me emrin Pazari i Derexhikut. Ky pazar ka funksionuar që prej kohës së Gjergj Kastriot Skënderbeut në shek e XV, kur dyqanet e tij arrinin deri pranë hyrjes së kalasë.



Veshje tradicionale

## ÇARSHIA E STAMBOLLIT

Pazari i Madh në Stamboll është një nga tregjet më të mëdha dhe më të vjetra të mbuluara në botë, me 61 rrugë të mbuluara dhe mbi 4.000 dyqane në një sipërfaqe totale prej 30.700 m<sup>2</sup>, duke tërhequr nga 250.000 deri në 400.000 vizitorë çdo ditë. Pazari i Madh në Stamboll shpesh konsiderohet si një nga qendrat e para tregtare në botë.

1456



Punimi i llambave



1462

## ÇARSHIA E SARAJEVËS

Stari Grad është një komunë e qytetit të Sarajevës, Bosnje dhe Hercegovinës. Është pjesa më e vjetër dhe më e rëndësishme historikisht e Sarajevës. Në zemër të saj është pjesa e sektorit të tregut të vjetër të qytetit ku qyteti u themelua në shekullin e 15-të.



Punimi i enëve



**2013**

**KUZHINA E HAPUR NË LJUBLJANË**

KUZHINA E HAPUR ËSHTË TREGU I PREFERUAR I USHQIMIT NË SLOVENI, QË NGA FILLIMET E TIJ NË 2013 ËSHTË BËRË PJESE INTEGRALE E GJALLËRISË SË LJUBLJANËS. DUKE BASHKUAR RESTORANTET MË TË MIRA NGA I GJITHË VENDI, KJO KUZHINË OFRON NJË EKSPERIENCË SHUMËNGJYRËSHE.



**1967**

**TREGU I KRISHTLINDJEVE NË GRAZ**

ËSHTË NJE HAPËSIRË ME SHKËLQIM SEZONAL TË NJË MORIE TË DRITAVE DHE ATMOSFERË FESTIVE QË PËRMBAN SHTËPIZA APO TREGJE QË LIDHEN ME ATMOSFERËN E KRISHTLINDJEVE, ME SKULPTURA TË NDRYSHME NGA AKULLI TË DEDIKUARA PËR FESTËN.



**2006**

**FESTIVALI I RRUGËS NË PECAN**

FESTIVALI I RRUGËS PECAN ËSHTË NJË NGA FESTIVALET MË TË MËDHA DHE MË TË GJATA TË ARTEVE / ARTIZANATIT DHE MUZIKËS NË VEND.



## 2.0 Punëtorja e vizionimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë

### 2.1 Qëllimi i punëtorisë dhe objektivat

Punëtorja për vizionimin e Çarshisë së Madhe në Gjakovë vie si iniciativë e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, respektivisht Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Gjakovë, në bashkëpunim me QJQ EC Ma Ndryshe, dhe me kontribut të Komunës së Gjakovës, për të bërë vizionimin e Çarshisë së Madhe të Gjakovës, bazuar në metodologjinë e planifikimit me pjesëmarrje.

Qëllimi primar i punëtorisë konsiston në përfshirjen e grupeve të ndryshme të komunitetit, përfshirë këtu qytetarët e Gjakovës, bizneset aktive në kuadër të çarshisë, përfaqësuesit e grupeve të marginalizuara të komunitetit, përfaqësuesit e organizatave aktive, përfaqësuesit e institucioneve dhe profesionistët e lëmive relevante në

parashtrimin e kërkesave, shqetësimeve dhe propozimeve për të ardhmen e Çarshisë së Madhe në Gjakovë.

**Ilustrimi në vijim: Planifikimi me pjesëmarrje.**



### Qëllimi i punëtorisë

- Punëtorja për vizionimin e Çarshisë së Madhe në Gjakovë është e bazuar në metodologjinë e planifikimit me pjesëmarrje.
- Kontributet e grupeve të ndryshme të komunitetit në parashtrimin e problemeve, kërkesave dhe propozimeve për të ardhmen e Çarshisë së Madhe, përbëjnë bazën e raportit të vizionimit dhe fazave të mëtutjeshme të planifikimit.

Për ta bërë të mundshme këtë, EC Ma Ndryshe ka organizuar tri takime me kategori të specifikuar të komunitetit, përkatësisht një takim me qytetarë, një takim me përfaqësues të bizneseve dhe një takim me përfaqësues institucional dhe profesionistë. Pjesëmarrësit janë rekrutuar përmes thirrjes së hapur publike, të shpërndarë me pamfleta në hapësirat publike të Çarshisë së Madhe në Gjakovë dhe poashtu përmes platformave të rrjeteve sociale të organizatës.



Në objektivat kryesore të punëtorive të realizuara mund të cilësohen:

- Vënja e grupeve komunitare në qendër të procesit të planifikimit, si kundërpërgjigje ndaj persiatjeve të ndryshme për intervenime të ngutshme dhe të pa bazuara në kërkesat e komunitetit në Çarshinë e Madhe të Gjakovës
- Hapja e procesit të planifikimit në sistem të konsoliduar sipas principit 'nga poshtë-lartë', me qëllim të identifikimit të kërkesave, shqetësimeve dhe propozimeve direkte të komunitetit për të ardhmen e Çarshisë së Madhe të Gjakovës
- Krijimi i një databaze dhe të dhënave statistikore lidhur me kërkesat, shqetësimet dhe propozimet e grupeve të komunitetit për të ardhmen e Çarshisë së Madhe të Gjakovës

- Përkthimi i kërkesave, shqetësimeve dhe propozimeve të grupeve të komunitetit në një projekt vizionues të Çarshisë së Madhe të Gjakovës, si paraprijës i projektit ideor për këtë tërësi urbane.



Fig. 6. Procesi i thirrjes për pjesëmarrje në punëtoritë me komunitetin

## 2.2 Mjetet dhe metodologjia e punës

Metodologjia e punëtorisë bazohet në principin e përfshirjes së komunitetit në fazat e hershme të planifikimit. Pas një hulumtimi fillestar lidhur me gjendjen aktuale të Çarshisë së Madhe në Gjakovë, dokumenteve relevante, dispozitave ligjore dhe intervenimeve të deritanishme, është punuar në drejtim të dizajnit të mjeteve të punës të cilat do të aplikoheshin përgjatë punëtorive.

Shtylla bazë e metodologjisë së punëtorive është bazuar në qëllimin e nxitjes së interaksionit në mes të pjesëmarrësve nga grupet e ndryshme të komunitetit me qëllim të përfshirjes së tyre sa më aktive në fazën e hershme të projektit të vizionimit. Strategjia ndërvepruese kishte për qëllim që të nxirte rezultate konkrete mbi shqetësimet ditore me të cilat grupet e caktuara të komunitetit përballen në baza ditore, memorijen kolektive të tyre lidhur me fazat e hershme/burimore të çarshisë,

nevojat e tyre rreth një jete më të mirëqenë dhe bizneseve më proaktive, vizionit të tyre për gjallërimin e hapësirave të pa shfrytëzueshme të çarshisë dhe qështje të tjera të rëndësishme. Punëtorja konkretizohej në tri mjete të ndryshme të punës, të cilat varionin nga modalitetete të ndryshme të teknikave ndërvepruese, që nga diskutimi, hartëzimi dhe shprehja në të shkruar.



Fig. 7 Realizimi i punëtorive bazuar në metodologjinë e planifikimit me pjesëmarrje

## **MJETI 1: Diskutim mbi përparësitë dhe mangësitë e Çarshisë së Madhe në Gjakovë**

Pjesëmarrësit e punëtorive janë nxitur që të diskutojnë rreth përparësive dhe mangësive të çarshisë, bazuar në eksperiencat dhe nevojat e tyre ditore. Diskutimi është përdorur si mjet për të shpalosur pikëvështrimet e tyre individuale, por edhe për të ballafaquar mendimet e ndryshme në mes të të pranishmëve.

Diskutimet janë nxitur nga fasilitatorët e punëtorisë, duke i asistuar njëherit pjesëmarrësit e punëtorive në kategorizimin e mendimeve të tyre në shtylla/tematika kryesore, të cilat do të ndihmonin më tutje procesin e vizionimit. Në fund të kohës së ndarë për të realizuar mjetin e parë të punëtorisë, pjesëmarrësit, të ndihmuar nga fasilitatorët, kanë listuar pikat kyçe të diskutimit të kategorizuara në dy shtylla kryesore: atë të përparësive dhe mangësive.



## MJETI 2: Identifikimi dhe hartëzimi i problemeve

Pas shterrimit të diskutimeve mbi përparësitë dhe mangësitë që e karakterizojnë aktualisht Çarshinë e Madhe në Gjakovë, pjesëmarrësit janë ftuar që nga teknika e diskutimit, të kalojnë në teknikën e skicimit dhe hartëzimit. Të ndodhur para hartave punuese të çarshisë dhe kufinjëve definues të saj, ata kanë identifikuar pikat më kritike të Çarshisë së Madhe të Gjakovës, duke hartëzuar në këtë mënyrë problemet që i rrethojnë ata në baza ditore,

por edhe potencilet dhe ndryshimet të cilat i shohin të nevojshme në të ardhmen.

Hartëzimi si mjet pune ka vënë në dispozicion për ekipin punues informata shumë të rëndësishme të cilat më pas kanë gjetur aplikim në masterplanin e vizionimit, duke qenë se lokalizimi i problemeve dhe propozimeve në harta të punës është tregues shumë konkret i kërësave të komunitetit.



ÇARSHIA E  
GJAKOVËS

### **MJETI 3: Lista e prioriteteve**

Mjeti i tretë i punës, për dallim nga mjeti i parë dhe i dytë që janë ideuar të funksionojnë në cilësinë e punës në grupe, është dizajnuar si teknikë pune individuale. Pjesëmarrësve u janë shpërndarë fleta punuese në të cilat janë ftuar që të bëjnë prioritizimin e pesë intervenimeve më urgjente dhe më të dëshirueshme në pikëvështrimin e tyre individual. Teknika e punës është menduar të jetë shprehja në të shkruar.

Lista e prioriteteve në kuadër të punëtorisë vie pas diskutimeve të anëve kryesisht të errëta të gjendjes ekzistuese në Çarshinë e Madhe në Gjakovë, përkatësisht pas identifikimit dhe hartëzimit të problemeve kryesore në hartën punuese të çarshisë. Si mjet, është ftesë për shprehje të pikëpamjeve individuale në perspektivë, duke aluduar më tepër në të ardhmen e çarshisë dhe në aspektet e domosdoshme pozitive në trajtimin e saj.



## 2.3 Rezultatet e dalura nga punëtoritë sipas mjeteve të punës

### Rezultatet nga MJETI 1:

Rezultatet e diskutimeve të përparësive dhe mangësive të Çarshisë së Madhe të Gjakovës të trajtuara në kuadër të mjetit të parë të punës, janë prezentuar në organograme të ndara përkitazi me kategorizimin e takimeve, respektivisht ato të realizuara me qytetarë, përfaqësues të bizneseve si dhe përfaqësuesit institucional dhe profesionistë.

Ajo që mund të spikatet nga kjo përmbledhje diskutimesh është se qytetarët e shohin si jashtëzakonisht shqetësuese qështjen e humbjes së autenticitetit të çarshisë, duke e ndërlidhur këtë sidomos me intervenimet e fundit që janë bërë në materializimin e rrugëve të saj. Mobiliteti brenda çarshisë dhe qështja e menaxhimit të automjeteve mbeten poashtu ndër shqetësimet kryesore. Organizimi më i mirë

i hapësirës në afërsi të kafiterive, sikurse edhe zgjidhja e dis-harmonisë momentale arkitekturale, mbeten ndër kërkesat e tyre më të prioritizuara.

Përfaqësuesit e bizneseve në kuadër të mjetit të parë të punëtorisë kanë proritizuar disa aspekte që sipas tyre mund të ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin më të mirë ekonomik të çarshisë. Ndër problemet aktuale kanë listuar mungesën e një koncepti zhvillimor të turizmit të çarshisë si dhe mungesën e mbështetjes së veprimtarisë së zejtarëve të vjetër. Problemet infrastrukturore, sikurse qështja e kanalizimit dhe e ndriçimit publik, janë vënë në theks të veçantë gjatë diskutimeve. Pronarët e bizneseve dhe zejtarët e vjetër kanë shprehur indinjatën e thellë poashtu për largimin me kohë edhe të tipareve karakteristike të dyqaneve të dikurshme, duke përfshirë: rritjen e pjergullave të hardhisë dhe rikthimin e strehëve të gjata, mvëshjen me baltë të ndërtesave të vjetra, venitjen e tipareve karakteristike të


hapësirës “Loma e Drithit” dhe të tjera karakteristika. Të gjitha këto elemente janë parë njehërit si potencial i madh rikthimi i vlerave burimore të Çarshisë së Madhe në Gjakovë dhe rritjes së mundësisë së zhvillimit ekonomik më të madh të kësaj tërësie urbane.

Përfaqësuesit e institucioneve dhe profesionistët e trashëgimisë kulturorore, arkitekturës dhe planifikimit urban kanë priorizuar nevojën për ideimin e një masterplani të konservimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë. Pjesë e rëndësishme e diskutimeve nga mjeti i parë i punëtorisë ka rezultuar të jetë edhe mungesa e një kornize ligjore për çarshinë si tërësi urbane dhe rrjedhimisht edhe definimi i kufijve mbrojtës të saj. Për nevoja të ideimit dhe poashtu për nevoja operacionale – menaxhuese të realizimit të planifikimit për intervenimeve në të ardhmen, është propozuar segmentimi i Çarshisë së Madhe në disa zona, të definuara poashtu me portat hyrëse. Është propozuar që kriteri

zhvillimor i çarshisë të jetë i bazuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale. Më konkretisht është propozuar që niveli qendror dhe lokal të ketë për prioritet qëshjen e çarshisë sa i përket investimeve kapitale, duke patur për fokus sidomos mbështetjen e zejeve të vjetra dhe promovimin e turizmit në kuadër të Çarshisë së Madhe në Gjakovë.

**Ilustrimet në vijim: Rezultatet nga mjeti i parë i punëtorisë.**





# ÇARSHIA E GJAKOVËS

RIKTHIMI I MVESHJES ME BALTË I NDËRTESAVE

RESTAURIMI I OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

VAZHDIMI I TRADITAVE - RITJIA E PJERGULLAVE TË HARDHISË

MBËSHTETJA E ZEJTARËVE SI FUNKSION PRIMAR

Aplikimi i materialeve natyrale

Ngritja e arshisë në aspektin kulturor dhe rëndësia e veçantë për bizneset

Rritja e hardhiwe dhe funksioni si hije natyrale

RIKTHIMI I HAPËSIRËS 'LOMA E DRITHIT'

Rikthimi i shitësve të drithërave; Zhvillimi i shumë aktiviteteve kulturore

**BIZNESET**

Strehët e gjata tek dyqanet

RIKTHIMI I STILIT TË MËPARSHËM TË DYQANEVE


Integrimi i programeve shtesë

Rritja e frekuentimit të arshisë

GUIDA TURISTIKE

ZHVILLIMI I TURIZMIT NË ARSHI

ARSHIA E GJAKOVËS



# ÇARSHIA E GJAKOVËS

## Rezultatet nga MJETI 2:

Rezultatet nga mjete i dytë i punëtorive të realizuara përkitazi me qytetarë dhe përfaqësues të bizneseve janë përmbledhur në hartat me konkluzione, të cilat pasqyrojnë saktësisht pikat më kritike në kuadër të Çarshisë së Madhe të Gjakovës, të identifikuar nga vetë pjesëmarrësit. Megjithëse qytetarët dhe pronarët e bizneseve kanë prezentuar dy grupe të ndryshme të komunitetit, me interesa tërësisht të veçanta, shumë nga shqetësimet dhe propozimet e të dyja palëve gjatë punës në hartëzim kanë gjetur përputhje.

Qytetarët kanë identifikuar në hartë hapësirat të cilat kërkojnë intervenim urgjent infrastrukturor, sa i përket trajtimit të kanalizimit, rikthimit të kalldërmit, trajtimit të ndriçimit publik etj. Ata poashtu kanë identifikuar pikat ku mendojnë se çarkullimi i automjeteve mund të gjejë përmirësim, siç është vendosja e

pengesave rrugore për çarkullim të automjeteve në indin kryesor rrugor të çarshisë, gjetjen e modalitetit për reduktimin e çarkullimit të lartë të makinave në rrugën perimetrike të çarshisë si dhe krijimin e një parkingu publik. Propozimet në hartën e Çarshisë së Madhe nga ana e qytetarëve kanë të bëjnë poashtu edhe me intervenime përmbajtësore si: rikonstruimin dhe ridizajnimin e urave lidhëse me çarshinë, shtimin e gjelbërimit përgjatë shtratit të Lumit "Krena", rrënimin e ndërtimeve tek "Bregu i Sarajit", organizimin më të mirë të veprimtarisë së kafiterive, rifunksionalizimin e "Tregut të Gjelbërt dhe Bylmetit" si dhe integrimin e toaleteve publike.

Në anën tjetër, përfaqësuesit e bizneseve kanë identifikuar hapësirat në të cilat sipas tyre duhet të bëhet zonimi i aktiviteteve të bizneseve, si diçka e cila do të rriste potencialin zhvillimor të Çarshisë së Madhe dhe njëherit kualitetin përmbajtësor të saj.

Ata poashtu kanë bërë idenfikimin e hapësirave të cilat kërkojnë ndalim urgjent të çarkullimit të automjeteve si dhe trajtimin e përgjithshëm të mobilitetit, që do të nënkuptonte më shumë hapësirë të lirë për lëvizjen e qytetarëve dhe njëherit më shumë hapësirë ekspozuese për zejet. Përfaqësuesit e bizneseve poashtu kanë prioritzuar nevojën për largimin e strukturës së fontanës dhe aktualizimin e hapësirës “Loma e Drithit” sipas tipareve të saj burimore.

**Ilustrimet në vijim: Rezultatet nga mjeti i dytë i punëtorisë.**

# KONKLUZIONI NGA TAKIMI ME QYTETARËT

7/10/2023

LEGJENDA

- RRUGËT
- KUFIRI I ÇARSHISË
- LUMI KRENA

1. VENDOSJA E WC-VE PUBLIKE

2. RIKTHIMI I GURËVE AUTENTIK

3. FREKUENTIM I LARTË I MAKINAVE

4. MUNGESË E TROTUARIT

5. RESTAURIMI I OBJEKTEVE KULTURORE

6. VENDOSJA E NDËRPRERËSVE PËR QARKULLIMIN E MAKINAVE

7. VENDOSJA E NDRIÇIMIT

8. RIFUNKSIONALIZIMI I PAZARIT TË BYLMETIT DHE TË GJELBËRT

17. ORGANIZIMI MË I MIRË I HAPËSIRËS SË SHFRYTËZUESHME NGA KAFITERITË

16. MUNGESA E DRENAZHIMIT KANALIZIMI ATMOSFERIK I HAPUR

15. HAPËSIRË PAMJAFTUESHME E PARKINGUT TE SAHAT KULLA

14. RRËNIMI I NDERTIMEVE TEK BREGU I SARAJIT

13. RIKTHIMI I KAFITERIVE

12. RIFUNKSIONALIZIMI I PAZARIT TË BYLMETIT DHE TË GJELBËRT

11. INTERVENIM NË SHTRATIN E LUMIT SHTIMI I GJELBËRIMIT

10. VENDOSJA E HIDRANTËVE NË AKSET KRYESORE

9. RIKONSTRUKTIMI DHE DIZAJNIMI I URAVE LIDHËSE

18. SHKARKIMI I RRUGËS QAZIM BAKALLI

# KONKLUZIONI NGA TAKIMI ME BIZNESET

7/10/2023

- LEGJENDA
- RRUGËT
  - KUFIRI I ÇARSHISË
  - LUMI KRENA

8. PËRZIERJA E UJIT ATMOSFERIK ME UJRAT E ZEZA \KANALIZIMI

9. NDALJA E QARKULLIMIT TË AUTOMJETEVE

1. HAPËSIRË ME VLERA TË TRASHËGIMIS KULTURORE

2. HAPËSIRË ME POTENCIAL PËR MBAJTJEN E AKTIVITETEVE

10. NDËRHYRJA NË BIZNESE NGA SANIMET

11. LOMA E DRITHIT - HAPËSIRË POTENCIALE PËR NJË TREG MOBIL

3. PARKING NËNTOKËSOR

4. QARKULLIMI ME MAKINA VETËM PËR BANOR NË RR. SAFEDIN XERXA

12. ZONIMI I AKTIVITETEVE TË NJEJTA

5. RESTAURIMI I KULLËS SË BEGUT


13. HEQJA E FONTANËS

6. RIFUNKSIONALIZIMI I OBJ. SI ENT PËR URBANISTË DHE ARKITEKTË

14. MIRËMBAJTJA E VARREZAVE TE XHAMIA E HADUMIT

7. LARGIMI I RRETH-RROTULLIMIT

# ÇARSHIA E GJAKOVËS



### **Rezultatet nga MJETI 3:**


Të dhënat statistikore kanë listuar prioritetet e deklaruara individualisht nga pjesëmarrësit e punëtorive me qytetarë, përfaqësues të bizneseve si dhe përfaqësues të institucioneve dhe profesionistë. Listimet e kategorizuara në përqindje dëshmojnë për preferenca të ndryshme të individëve pjesëmarrës në punëtori, por njëherit shpërfaqin tematikat e njejta, të përseritura nga të tri takimet. Ky indikator dëshmon se problemet ekzistuese në kuadër të Çarshisë së Madhe të Gjakovës janë tërësisht të vërejtshme, dhe ato paraqesin shqetësime të përbashkëta për të gjitha kategoritë e komunitetit, qofshin ata qytetarë kalimtarë, banorë të lagjes, shfrytëzues të kafiterive, blerës të zejeve të ndryshme apo profesionistë të fushës.

**Ilustrimet në vijim: Rezultatet nga mjeti i tretë i punëtorisë.**



# KONKLUZIONET NGA PUNËTORIA ME QYTETARËT


07/10/23



ÇARSHIA E GJAKOVËS

# KONKLuzionet nga Punëtorja me Biznese


18/10/23



ÇARSHIA E  
GJAKOVËS

# KONKLuzionet nga Punëtorja me Institucione

18 /10/23



ÇARSHIA E GJAKOVËS



## 3.0 Vizionimi i Çarshisë së Madhe në Gjakovë

### 3.1 Koncepti i vizionimit

Koncepti i vizionimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë është derivat i punëtorive të realizuara me përfaqësues të grupeve të ndryshme të komunitetit, respektivisht të takimeve me qytetarë, përfaqësues të bizneseve si dhe përfaqësues institucional. Poashtu, vizionimi merr për bazë hulumtimet paraprake të realizuara mbi gjendjen burimore të çarshisë, dokumentet planifikuese rreth saj si dhe raporte të ndryshme të publikuara deri në momentin e realizimit të këtij dokumenti.

Më konkretisht, ky koncept merr për bazë primare rezultatet e tri mjeteve të punës të realizuara në kuadër të punëtorive vizionuese e të përkthyer në propozime konkrete lidhur me të ardhmen e Çarshisë së Madhe të Gjakovës. Poashtu është një

ndërthurje e dokumenteve të planifikimit dhe atyre vizionuese të vëna në dispozicion në fazën fillestare hulumtuese, duke përfshirë sidomos këtu dokumentet "Studimi i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe të Gjakovës 1979-1982" dhe "Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë - 2015"


Bazuar në këto të dhëna kumulative, Çarshia e Madhe e Gjakovës sipas këtij projekti vizionues mëton të jetë një tërësi urbane me rëndësi të veçantë në aspektin e kualitetit vizuel dhe përmbajtësor.

Ky koncept synon që Çarshia e Madhe e Gjakovës në cilësinë e një kompleksi kulturor, historik, turistik dhe zejtar, të promovojë vlera të trashëgimisë kulturore dhe të shndërrohet në një vend të zhvillimit ekonomik dhe të promovimit të vlerave kulturore e sociale.

Ky vizionim ka për qëllim hapjen e horizonteve të reja për mundësi të

regjenerimit urban të tërësisë urbane të Çarshisë së Madhe të Gjakovës në një hapësirë multifunktionale, në të cilën mbizotërojnë vlerat arkitektonike tradicionale të mveshura me memorien kolektive të qytetarëve. Sipas këtij vizionimi, strukturat ndërtimore ekzistuese brenda çarshisë mëtojnë të mundësojnë: vazhdimësinë e veprimtarisë së zejeve të vjetra, krijimin e hapësirave rekreative dhe shërbyese për qytetarë dhe vizitorë, krijimin e hapësirave për qëndrim më të gjatë të turistëve në qytetin e Gjakovës (përmes bujtinave) si dhe organizimin e shumë aktiviteteve kulturore dhe artistike të cilat do të ndikonin në gjallërimin e hapësirave të lëna pa interes për tu vizituar dhe përjetuar.

**Ilustrimi në vijim: Koncepti i vizionimit të  
Çarshisë së Madhe të Gjakovës.**



SHFAQJE MUZIKORE




SHTIMI I  
AKTIVITETEVE

INKUADRIMI I SHESHIT MULTIFUNKSIONAL  
TE LOMA E DRITHIT



INKUADRIMI I KINEMASË SË HAPUR  
TEK HAPËSIRA E LUMIT



• INKUADRIMI I SHTEGUT PËR  
BIÇIKLETA TEK SHËTITORJA E LUMIT  
• PORTAT HYRËSE



LOKALET  
STREHËT E GJATA  
RIKTHIMI I TRADITËS NGA  
PJERGULLAT E HARDHISË




BËRTHAMA E ÇARSHISË  
NDARJA E FUNKSIONEVE  
FOKUS I VEQANTË ZEJEVE  
SI FUNKSION PRIMAR




PROGRAM SHITESË BUJTINAT  
"BED AND BREAKFAST"  
SI FUNKSION I RËNDËSISHËM PËR TURIZMIN  
DHE FREKUNETIMIN E ÇARSHISË

# KONCEPTI I ZHVILLIMIT TË ÇARSHISË

KONCEPTI I ZHVILLIMIT TË ÇARSHISË SË MADHE TË GJAKOVËS SYNON RUAJTEN E FRYËS ORIGINALE, VAZHDIMIN E TRADITAVE DHE KRIJIMIN E GJALLËRISË URBANE PËRMES RI-AKTIVIZIMIT TË SHUMË FUNKSIONEVE KYRESORE TË CILAT DIKUR E BËNIN ATË SI DENDËR SHUMË TË RËNDËSISHME EKONOMIKE E KULTURE.



KONCEPTI I SEGMENTIMIT  
TË ÇARSHISË



ZONAT FUNKSIONALE

ÇARSHIA E MADHE

SEGMENTIMI I  
ÇARSHISË NË ZONA ME  
FUNKSIONE TË NJËJTA

# ÇARSHIA E GJAKOVËS



### **3.2 Definimi i pesë shtyllave programore**

Vizionimi i Çarshisë së Madhe të Gjakovës bazohet në pesë shtylla kryesore programore, e të cilat zërthehen në propozime për intervenime konkrete në kuadër të tërësisë urbane të shqyrtuar:

#### **1. TRAJTIMI I TRASESË SË RRUGËS QENDRORE – RIKTHIMI I KALLDËRMIT**

Bazuar në shqetësimet e qytetarëve, pronarëve të bizneseve si dhe profesionistëve të fushës lidhur me largimin e kalldërmit dhe nismat e mëhershme për intervenime sanuese të infrastrukturës ekzistuese e të cilat kanë ndikuar në humbjen e elementeve burimore të Çarshisë së Madhe, ky vizionim vë theks në trajtimin e trasesë së rrugën qendrore (sipas projektit të fundit intervenues dhe parimeve të definuara nga MKRS në vitin 2022). Vizionimi propozon që në këtë segment rrugor të bëhet rikthimi i kalldërmit dhe realizimi i detajit të

propozuar nga komisionet profesionale, që ka për bazë rikthimin e elementeve autentike të rrugëve të çarshisë, eliminimin e problemeve të shumta infrastrukturore të evidentuara momentalisht në këto rrugë (përfshirë sanimin e problemeve me kanalizim, ujëmbledhës dhe ndriçimin publik), përmirësimin e kushteve operuese të bizneseve aktuale dhe rritjen e kualitetit vizuel për vizitorë.

#### **2. ZONIMI I ÇARSHISË SË MADHE NË NËNZONA - ZHVILLIMI I KONCEPTIT TË PORTAVE HYRËSE**

Marrë për bazë sipërfaqen e madhe në të cilën shtrihet Çarshia e Madhe e Gjakovës, ky vizionim parasheh zonimin e saj në disa nën-zona të cilat do të mundësoni trajtimin parcial të saj në proceset planifikuese dhe poashtu ato zbatuese. Duke u bazuar në propozimet e dalura përgjatë punëtorive nga ana e përfaqësuesve institucional dhe profesionistëve, si dhe në propozime të ngjashme të evidentuara në dokumente paraprake, ky vizionim propozon zonimin e

çarshisë në: bërthamën e madhe, aneksin e bërthamës së madhe si dhe potezin verior dhe jugor të çarshisë. Zonimi do të kishte impakt pozitiv edhe në prioritizimin e intervenimeve të ndërmarra nga niveli lokal dhe qendror lidhur me intervenimet e ardhshme në Çarshinë e Madhe, duke qenë se mbulueshmëria e sipërfaqeve më të vogla do të rriste praktikitetin dhe efikasitetin në planifikim dhe ekzekutim.

Zonimi parasheh poashtu zhvillimin e konceptit të portave hyrëse, të cilat do të ndodhnin në hyrje të bërthamës së madhe në njërin anë, dhe të aneksit të bërthamës në anën tjetër. Në këtë mënyrë, lëvizshmëria dhe përjetimi i aktiviteteve përgjatë çarshisë do të ndodhte brenda një 'fillimi' dhe një 'mbarimi'.

### **3. STIMULIMI I ZHVILLIMIT TË ZEJEVE – EKSPOZIMI I TYRE MË I MADH SI KOMPONENTË E EDUKIMIT JOFORMAL**

Shtylla e tretë e vizionimit ndalon në trajtimin e situatës aktuale të zejeve dhe shqetësimit të transmetuar përgjatë punëtorive nga ana e qytetarëve dhe zejtarëve të vjetër lidhur me këtë kategori të trashëgimisë kulturore. Numri i madh i zejeve gjithnjë në zhdukje si dhe numri i madh i dyqaneve të mbyllura dhe jo aktive në kuadër të çarshisë ka dalë të jetë indikacion i mjaftueshëm që njëra ndër shtyllat programore të vizionimit të Çarshisë së Madhe të jetë pikërisht stimulimi i zhvillimit të zejeve. Vizionimi parasheh promovimin e zejeve të vjetra përmes zhvillimit të edukimit joformal, përkatësisht organizimit të aktiviteteve ekspozuese, trajnimeve aftësuese dhe shkollave verore të cilat do të përfshinin në mënyrë aktive fëmijët, gjeneratat e reja dhe turistët në programe të edukimit përgjatë së cilave ata do të informoheshin për zejjet dhe edhe do të aftësoheshin për ushtrimin e tyre. Përfshirja e tillë interaktive e

komunitetit në mbajtjen gjallë të trashëgimisë shpirtërore do të ndikonte edhe në aktivizimin e vetë çarshisë dhe në zhvillimin ekonomik të saj.

Vizionimi poashtu parasheh aktivizimin e **rrugëve model** të cilat konsistojnë me veprimtarinë e zejeve ndër më të vjetra, siç është "Rruga e Kutixhinjëve" dhe "Rruga e Jorganxhinjëve" dhe kthimin e tyre në rrugë 'ekspozuese' dhe të zhvillimit të edukimit joformal. Koncepti i rrugëve model do të mund të zgjerohen edhe në rrugë të tjera në kuadër të çarshisë.

#### **4. ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË CILAT PASUROJNË OFERTËN TURISTIKE - "DITËT E ÇARSHISË SË MADHE NË GJAKOVË", "FESTVALI I KËNGËS SË VJETËR QYTETARE", KINEMA "LOMA E DRITHIT", AKTIVITETE PËR EKSPOZIMIN E USHQIMIT DHE ZEJEVE LOKALE**

Numri I madh I lokaleve të mbyllura aktualisht në kuadër të Çarshisë së Madhe të Gjakovës dhe devastimi I hapësirave publike si rezultat I mungesës së

mirëmbajtjes infrastrukturore dhe mungesës së aktiviteteteve, ka priorizuar nevojën për pasurimin programativ të çarshisë përmes ideimit të aktiviteteteve të ndryshme të cilat do të mund të organizoheshin në 67ocale67t të ndryshme kohore, me përsëritje javore, mujore apo vjetore. Në të gjitha takimet e zhvilluara me përfaqësues të komunitetit, hapësira e njohur si "Loma e Drithit" është 67oca si potencial për zhvillim të mëtutjeshëm në cilësinë e një hapësire publike 67ocale67tive në të cilën do të mund të zhvilloheshin aktivitete të ndryshme. Poashtu janë identifikuar edhe hapësira të tjera të cilat do të mund të regjeneroheshin me potencial për akomodimin e aktiviteteteve të ndryshme kulturore, përfshirë këtu edhe hapësirat përreth shtratit të lumit "Krena". Ky vizionim jep disa modalitete të organizimit të aktiviteteteve të ndryshme (të propozuara tashmë në kuadër të dokumenteve ekzistuese dhe poashtu përgjatë punëtorive) që do të rrisnin qarkullimin dhe qëndrimin në çarshi, duke përfshirë këtu organizimet: "Ditët e Çarshisë së Madhe në Gjakovë", "Festivali I

këngës së vjetër qytetare”, Kinema “Loma e Drithit”, aktivitete për ekspozimin e ushqimit, të zejeve B&Bocale dhe aktivitete të ngjashme.

## **5. ZHVILLIMI I KONCEPTIT “B&B” – SI FORMË E FUNKSIONALIZIMIT TË BUJTINAVE DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK**


Numri i vogël i turistëve në qytetin e Gjakovës, dhe sidomos qëndrimi i shkurtër i tyre, kryesisht gjithëditor, ka nxitur pjesëmarrësit e punëtorive për propozimin e zhvillimit të një koncepti tashmë të njohur në rajon dhe më gjerë, atë të bujtinave “Bed & Breakfast”.

Shumë ndërtesa ekzistuese në kuadër të Çarshisë së Madhe, të zhvilluara në dy etazhe, mundësojnë realizimin e një koncepti të tillë, i cili do tu ofronte turistëve mundësi të qëndrimit/fjetjes në kuadër të indit urban të qytetit të Gjakovës për një apo më shumë netë. Zhvillimi i bujtinave do të paraqiste një atraksion për turistët potencial, të cilët përveç shfrytëzimit të hapësirave shërbyese-hotelierike, gjatë qëndrimit të tyre në

çarshi do të mund të mësonin edhe për veprimtaritë e zejeve, të bëheshin blerës potencial të produkteve të tyre, të merrnin pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore dhe të përjetonin vlerat e përgjithshme kulturore që ofron Çarshia e Madhe e Gjakovës. Qëndrimi më i gjatë i turistëve do të nënkuptonte inkasim më të madh të të hyrave, rrjedhimisht zhvillim më të madh ekonomik të çarshisë. Arritja e zhvillimit të kësaj komponente, pra zhvillimit ekonomik, do të ndikonte edhe në lehtësimin e qështjes së menaxhimit të vetë çarshisë në të ardhmen.

**Ilustrimi në vijim: Zhvillimi i vizionimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë bazuar në pesë shtylla programative.**

1. TRAJTIMI I TRASES SË RRUGËS QENDRORE  
RIKTHIMI I KALLDËRMIT



2. ZONIMI I ÇARSHISË SË MADHE NË NËNZONA  
ZHVILLIMI I KONCEPTIT TË PORTAVE HYRËSE



3. STIMULIMI I ZHVILLIMIT TË ZEJEVE  
DHE EKSPOZIMI I TYRE MË I MADH  
SI KOMPONENTE E EDUKIMIT JOFORMAL



4. ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË CILAT PASUROJNË  
OFERTËN TURISTIKE

"DITËT E ÇARSHISË SË GJAKOVËS", "FESTIVALI I KËNGËS SË VJETËR QYTETARË", KINEMA "TE LOMA E DRITHIT", FESTIVALI I USHQIMIT ETJ

5. ZHVILLIMI I KONCEPTIT "B&B"  
SI FORMË E FUNKSIONALIZIMIT TË BUJTINAVE  
DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK



### **3.3 Propozimi i ndërhyrjeve konceptuale në strukturën ekzistuese**

Ky vizionim prezenton tri produkte themeltare të derivuara nga punëtoritë e realizuara përkitazi me qytetarë, përfaqësues të bizneseve dhe përfaqësues të institucioneve e profesionistë. Këto produkte grafike pasqyrojnë parashikimet për ndërhyrje në strukturën ekzistuese të Çarshisë së Madhe në Gjakovë, të një niveli konceptual – vizionues, me theksimin e nevojës për zhvillimin e një projekti ideor, dhe më pas kryesor, me qëllim të ekzekutimit të tyre. Produktet grafike përfshijnë:

#### **1. Masterplanin konceptual të Çarshisë së Madhë të Gjakovës**

Ky masterplan konceptual ndërthur të gjitha propozimet e dalura nga punëtoritë, përfshirë edhe të dhënat e rëndësishme nga dokumentet e shqyrtuara. Zhvillimi konceptual i çarshisë nënkupton një parashikim të zhvillimit të tërë çarshisë si

tërës urbane, të bazuar në pesë (5) shtyllat kryesore programative të elaboruara më sipër.

#### **2. Propozimin për trajtimin e trasesë në rrugën qendrore**

Kjo hartë konceptuale propozon trajtimin (me prioritet) të materializimit të trasesë në rrugën qendrore, respektivisht nevojën imediate për realizimin e projektit ideor, dhe më pas kryesor e ekzekutues të segmentit rrugor në aksin veri-jugor të çarshisë, tashmë subjekt i projektit të fundit të pezulluar (2022). Harta vë në theks rikthimin e materialeve burimore dhe promovimin e mënyrës tradicionale të aplikimit të tyre, fillimisht në rrugën qendrore të çarshisë e më pas edhe në rrugët e tjera, drejt unifikimit të trajtimit rrugor në të gjithë tërësinë urbane të Çarshisë së Madhe të Gjakovës.

### **3. Vizuelizimet e pesë shtyllave programative**

Situatat e prezentuara përmes vizuelizimeve ilustrojnë qëllimet e përcaktuara në kuadër të pesë shtyllave programative të vizionimit të Çarshisë së Madhe të Gjakovës. Ato ilustrojnë në mënyrë figurative intervenimet e parashikuara në kuadër të këtij vizionimi, duke parashtruar nevojën dhe idenë e përfshirjes së këtyre propozimeve në planifikime të nivelit më të detajuar (ideor, kryesor dhe ekzekutues, respektivisht/apo të projektit të regjenerimit urban të çarshisë).

**Ilustrimet në vijim: Masterplani konceptual i Çarshisë së Madhe ne Gjakovë ; Propozimi për trajtimin e trasesë së rrugës qendrore të Çarshisë së Madhe në Gjakovë.**



# HARTA- MASTERPLANI KONCEPTUAL I ÇARSHISË

## LEGJENDA

- BËRTHAMA E MADHE
- ANEKSI I BËRTHAMËS SË MADHE
- POTEZI JUGOR DHE VERIOR I ÇARSHISË
- RRUGA E KUTIJXHINJËVE
- RRUGA E JORGANGJINJËVE
- PORTAT HYRËSE
- BUJTINAT
- "WC" PUBLIKE
- LARGIMI I RRETH RROTULLIMIT
- INTEGRIMI I PARKINGUT PUBLIK
- RRËNIMI I BREGUT TË SARAJEVË
- RIKTHIMI I PAZARIT TË BYLMETIT
- KUFIRI I ÇARSHISË
- LUMI KRENA

## BUJTINAT

ZHVILLIMI I KONCEPTIT "B & B" SI FORMË E FUNKSIONALIZIMIT TË BUJTINAVE.



## ZEJET

STIMULIMI I ZHVILLIMIT TË ZEJEVE DHE EKSPOZIMI I TYRE MË I MADH.




## "LOMA E DRITHIT"

ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TEK LOMA E DRITHIT TË CILAT PASUROJNË OFERTËN TURISTIKE.



## TRAJTIMI I TRASESË

TRAJTIMI I TRASESË SË RRUGËS QËNDRORE-RIKTHIMI I KALLDËRMIT




# ÇARSHIA E GJAKOVËS

**Ilustrimi në vijim: Propozimi për trajtimin e trasesë së rrugës qendrore të Çarshisë së Madhe në Gjakovë.**




# HARTA E MATERIALIZIMIT TË TRASESË

- LEGJENDA
- RRUGËT
  - KUFIRI I ÇARSHISË
  - LUMI KRENA



## DETAJI I MATERIALIZIMIT TË TRASESË



KALDËRMI

GURË NATYRORË

UJËMBLEDHËSI

AMBULANTA E QYTETIT


KULLA E FAMILJES KRYEZIU

SHTËPIA E FAMILJES GREZDA

XHAMIA HADUMIT


DENDRA E INOVACIONIT

TEQJA E BEKTASHINJËVE



# ÇARSHIJA E GJAKOVËS

## 1. TRAJTIMI I TRASES SË RRUGËS QENDRORE RIKTHIMI I KALLDËRMIT




Ilustrimet në vijim: Vizuelizimet e situatave të propozuara në kuadër të pesë shtyllave programative të vizionimit të Çarshisë së Madhe të Gjakovës









**2. ZONIMI I ÇARSHISË SË MADHE NË NËNZONA**  
ZHVILLIMI I KONCEPTIT TË PORTAVE HYRËSE













**3. STIMULIMI I ZHVILLIMIT TË ZEJEVE  
DHE EKSPOZIMI I TYRE MË I MADH  
SI KOMPONENTE E EDUKIMIT JOFORMAL**





GARRI-V

BARCELONA



Ruzhdi Handi Qarri

B.I.





Hands 



Bimet



#### 4. ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË CILAT PASUROJNË OFERTËN TURISTIKE

"DITËT E ÇARSHISË SË GJAKOVËS", "FESTIVALI I KËNGËS SË VJETËR QYTETARË", KINEMA "TE LOMA E DRITHIT", FESTIVALI I USHQIMIT ETJ



AQIRA

BENI PERDE  
BENITA

CA  
EE



T-2  
T-3  
T-4  
T-5  
T-6  
T-7  
T-8  
T-9  
T-10

BEKA  
BEKA

moonlight

**5. ZHVILLIMI I KONCEPTIT "B&B"**  
SI FORMË E FUNKSIONALIZIMIT TË BUJTINAVE  
DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK





Paiz  
280-310

Beem

HAPUR  
KLIMA

BUJTINE



## Rekomandime për hapa të mëtutjeshëm zhvillimor të Çarshisë së Madhe në Gjakovë

Raporti i vizionimit të "Çarshisë së Madhe në Gjakovë" si proces gjithëpërfshirës, i bazuar në metodologjinë e planifikimit me pjesëmarrje, rekomandon disa hapa të mëtutjeshëm zhvillimor për Çarshinë e Madhe në Gjakovë, përfshirë këtu:

- Plotësimin e kornizës ligjore mbi Çarshinë e Madhe të Gjakovës, duke përfshirë hartimin e një plani të menaxhimit, krijimin e një trupi menaxhues, definimin e zonës së mbrojtur dhe përcaktimin e dispozitave ligjore në funksion të rregullimit të akteve intervenuese, ideuese dhe realizuese në të si tërësi e mbrojtur urbane
- Inicimin e hartimit të një masterplani të konservimit dhe (apo) regjenerimit urban të Çarshisë së Madhe në Gjakovë që do të mundësonte një trajtim të detajuar, profesional dhe të bazuar në rastet studimore të suksesshme të çarshive simotra
- Inicimin e projekteve të detajuara për pjesë të segmentuara të Çarshisë së Madhe të Gjakovës drejt trajtimit sa më të suksesshëm të saj dhe aplikimit të praktikave të mira
- Prioritizimin e Çarshisë së Madhe të Gjakovës në politikat e nivelit qendror dhe lokal drejt investimeve kapitale që do të mundësonin kthimin e gjendjes së saj burimore, regjenerimin e saj urban dhe implementimin e një vizioni gjithëpërfshirës me qëllim të aktivizimit dhe sigurimit të zhvillimit të saj ekonomik

- Valorizimit dhe ruajtjen urgjente të strukturave dhe elementeve burimore të mbijetuara nga faktori kohë si dhe rikthimin e elementeve burimore bazuar në dokumentacionin e trashëguar, memorien kolektive si dhe teknikat dhe parimet e definuara në kartat ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore
- Zbatimin e propozimeve të dalura nga ky vizionim, me theks në kërkesat dhe propozimet e grupeve të komunitetit, drejt arritjes së konceptimit të Çarshisë së Madhe të Gjakovës si një kompleks kulturor, historik, turistik dhe zejtar që promovon vlera të trashëgimisë kulturore dhe që shndërrohet në një vend të zhvillimit ekonomik, i prioritizuar për tu vizituar nga ana e qytetarëve dhe turistëve.



## Bibliografia

1. CHWB & Komuna e Gjakovës, Hapësira Historike Urbane – Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë, Gjakovë, 2022
2. EC Ma Ndryshe, Zhdukja e gjurmëve – Qendrat Historike të Kosovës, Prizren, 2015
3. JP – EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity (PCDK), Plani Rajonal i Trashëgimisë Kulturore 2012 – 2015 për Pejë, Klinë, Deçan, Istog, Junik dhe Gjakovë, Prishtinë, 2012
4. Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Projekt - Harta Zonale e Komunës së Gjakovës (Draft), Gjakovë, 2022
5. Kryeziu, A., Revitalization of the historic “Çarshia e Madhe” in Gjakova (Kosovo), Punim diplome – Master në Restaurim në Arkitekturë, Izmir, 2014
6. Kurtoviq, N., Antikitetet e Kosovës, “Studim për Revitalizimin e Çarshisë së Madhe në Gjakovë”, Prishtinë, 1984
7. MKRS, Dokumentacioni – kriteret dhe udhëzimet për hartim të projektit (Projekti për shtrimin e dyshemesë në bërthamën e Çarshisë së Madhe në Gjakovë), Prishtinë, 2022

## Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm.

Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare

afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse

dhe mënjaron veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;

3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;

4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

